



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

në lidhje

me mosushtrimin e mbikëqyrjes efektive nga Ministria e Arsimit, Shkencës,
Teknologjisë dhe Inovacionit ndaj funksionimit të Bartësve të Arsimit të Lartë

Rasti A. nr.24/2018

Rasti A. nr.790/2018

Rasti A.nr.605/2019,

Rasti A. nr.635/2020,

Rasti A. nr.534/2020,

Rasti A.nr.254/2021,

Rasti A.nr.276/2021,

Për: Znj. Arbërie Nagavci, Ministre

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Kopje: Z. Habit Hajredini, Drejtor

Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit

Prishtinë, më 2 dhjetor 2021

Qëllimi

Ky raport është hartuar mbi bazën e ankesave të pranuar nga Avokati i Popullit dhe të evidentuara sipas rasteve: A.nr. 24/2018, [redacted] A.nr. 254/2021, [redacted] A.nr. 534/2020, [redacted] dhe [redacted] A.nr. 790/2018, [redacted] A.nr. 635/2020, [redacted] A.nr. 605/2019, [redacted] dhe A.nr. 276/2021, [redacted]

Raporti trajton ankesat e pranuar nga Avokati i Popullit lidhur me mosnjohjen/mosverifikimin e diplomave të tyre. Në rastin e parë,¹ ankuesit kishin përfunduar programet studimore të cilat nuk kishin pasur akreditim dhe licencë; në rastin e dytë,² me rastin e regjistrimit të ankuesit në kolegji, kolegji kishte akreditim, mirëpo me rastin e përfundimit të studimeve, kolegji i ishte refuzuar kërkesa për riakreditim dhe si pasojë në këto raste diplomat e tyre nuk mund të njihen/verifikohen dhe ankuesit nuk mund t'i vijojnë studimet jashtë vendit. Në rastet e tjera,³ ankuesve nuk mund t'u njihen/verifikohen diplomat për shkak të mosdorëzimit të librave amë nga Bartësit e Arsimit të Lartë (BAL) dhe të njëjtët po ashtu nuk mund t'i vijojnë studimet jashtë vendit.

Duke pasur parasysh se çështja e njohjes/verifikimit të diplomave është çështje e papërfunduar dhe e cila vazhdimisht është trajtuar nga institucionet, por edhe nga studentët dhe publiku, në njëhën anë, vazhdimisht kjo çështje ka krijuar pasiguri juridike për studentët, ndërsa në anën tjetër, mosveprimi i institucioneve përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave ligjore ka krijuar hapësira që BAL-i të funksionojë në kundërshtim me dispozitat ligjore, konkretisht pa akreditim dhe pa e dorëzuar dokumentacionin, i cili parashihet sipas dispozitave ligjore, është e nevojshme që institucionet përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit t'i ndërmarrin veprimet ligjore lidhur me çështjen e njohjes/verifikimit apo mosnjohjes/mosverifikimit të diplomave, në mënyrë që kjo çështje të përfundojë dhe në të ardhmen studentët të angazhohen më shumë në mësimnxënie e jo të përballen me probleme të kësaj natyre.

Kompetencat e Avokatit të Popullit

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Kushtetuta), në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: *"Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike"*; kurse në paragrafin 3 përcakton: *"Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj."*

¹ A.nr. 24/2018, [redacted]

² A.nr. 254/2021, [redacted]

³ A.nr. 534/2020, [redacted]

[redacted] A.nr. 790/2018, [redacted]

[redacted] A.nr. 635/2020, [redacted]

[redacted] A.nr. 605/2019, [redacted]

[redacted] dhe A.nr. 276/2021, [redacted]

2. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, ndër të tjera, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- *“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.”* (Neni 18, par. 1, nënpar. 1.2).
- *“Të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.”* (Neni 18, par. 1, nënpar. 5).
- *“T’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.”* (Neni 18, par. 1, nënpar. 6).
- *“Të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.”* (Neni 18, par. 1, nënpar. 7).
- *“Të përgatisë raporte, vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës.”* (Neni 18, par. 1, nënpar. 8).
- *“T’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv.”* (Neni 18, par. 1, nënpar. 9).

Me dërgimin e këtij Raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij, Avokati i Popullit synon t’i kryejë këto përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore.

Përmbledhje e rasteve që i ka në trajtim Avokati i Popullit

Rasti nr.24/2018. [REDAKTUAR]

3. Avokati i Popullit më 16 janar 2018 kishte pranuar ankesën e z. [REDAKTUAR] në emër të një grupi prej 105 (njëqind e pesë) studentësh të diplomuar në Universitetin Publik të Prizrenit “Ukshin Hoti” (më tej: UPP), në drejtimet: gjuhë dhe letërsi angleze, matematikë – informatikë, fizikë – kimi, të regjistruar në vitin akademik 2012/2013, për, siç theksonin ata, mosnjohjen e diplomave jashtë Republikës së Kosovës duke ua pamundësuar kështu vazhdimin e studimeve sipas përcaktimeve të tyre.
4. Ankuesit kishin deklaruar se kishin përfunduar studimet në UPP dhe ishin pajisur me diploma, mirëpo kishin probleme lidhur me vazhdimin e studimeve jashtë Republikës së Kosovës, meqë diplomat e tyre nuk njiheshin.
5. Meqenëse diplomat e tyre nuk ishin pranuar, ata i ishin drejtuar Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKK), nga e cila kishin marrë informatën se këto programe studimore në UPP, për vitin akademik 2012/2013, nuk kishin qenë të akredituara.
6. Në kopjen e Shkresës Nr.192/01B, e datës 13 korrik 2012, të cilën e kishin dorëzuar ankuesit, kuptohet se MASH-T-i kishte aprovuar në tërësi numrin e studentëve të propozuar nga UPP-ja për studime në këto programe studimore në vitin akademik 2012/2013, ndërsa

ish-ministri i MASHT-it, z. Ramë Buja, lidhur me këto programe, më 18 prill 2014 kishte nxjerrë Vendimin Nr.061/01B për njohjen e diplomave për studime dhe punësim për të gjithë studentët e regjistruar në fakultetet e edukimit në universitetet publike, në fazën e transformimit të programeve lëndore, për vitin akademik 2011/2012 dhe 2012/2013.

7. Më 28 shkurt 2017, ankuesit i ishin drejtuar Departamentit për Arsim të Lartë (DAL) me Shkresën Nr. Prot. 1153, mirëpo nuk kishin marrë asnjëherë përgjigje në formë të shkruar.
8. Më 31 janar 2018, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit kishte biseduar me sekretarin e Fakultetit të Edukimit, nga i cili ishte njoftuar se në DAL ishin dërguar të gjitha shënimet për numrin e studentëve të diplomuar në këtë fakultet, gjithashtu kishte shtuar se e njëjta situatë ishte edhe në fakultetet e edukimit në Gjiilan dhe në Gjakovë, për shkak se në këtë periudhë nuk kishin qenë të akredituara.
9. Duke pasur parasysh se ankuesit ishin regjistruar në vitin akademik 2012/2013, si dhe Informatën për vendimin e MASHTI për caktimin e numrit të studentëve për t'u regjistruar në Universitetin "Ukshin Hoti" në vitin akademik 2012/2013, Nr.192/01B, e datës 13.7.2012, këtij universiteti i ishte aprovuar nga MASHTI numri i studentëve për t'u regjistruar në këto programe studimi.
10. Po ashtu, më 18 prill 2014, z. Ramë Buja, në atë kohë ministër i MASHT-it, kishte nxjerrë Vendimin Nr.061/01B për njohjen e diplomave për studime dhe punësim, sipas të cilit përcaktohej: *"Për të gjithë studentët e regjistruar në Fakultetet e Edukimit në Universitetin e Edukimit në fazën e transformimit të programeve lëndore nga Fakulteti i Edukimit në departamentet tjera përkatës për vitin akademik 2011/2012 dhe 2012/2013."*
11. Më 4 gusht 2015, z. Arsim Bajrami, ministër i MASHT-it, kishte nxjerrë Vendimin Ref.nr.230/01B, me të cilin synohej rregullimi i çështjes së licencimit të programeve të Bartësit Privat të Arsimit të Lartë (BPrAL), por kishte lënë anash çështjen e universiteteve publike. Vendimi përcaktonte: *"Të diplomuarit në programet e studimit për përgatitje të mësimdhënësve të ofruara nga Bartësit Privat të Arsimit të Lartë (BPrAL), të regjistruar në programe të pa licencuara para hyrjes në fuqi të Ligjit nr.04/L-37 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare nr.14, 9 shtator 2011), duhet të përfundojnë Programin për Avancimin e Kualifikimit."*
12. Lidhur me çështjen e verifikimit të diplomave dhe dokumentacionit tjetër të lëshuar nga BPrAL-ja, më 29 korrik 2010 ishte nxjerrë Aneksi I i Udhëzimit Administrativ nr.3/2010, ku sipas nenit 2 përcaktohej: *"Plotësohet neni 5 paragrafi 1 të cilit i shtohet nënparagrafi 1.1, i cili do të ketë këtë përmbajtje: Të gjitha diplomat dhe dokumentet tjera nga programet e studimit të zhvilluara para vitit akademik 2007/2008, të cilat kanë filluar pa u pajisur me licencë dhe e njëjta iu është dhënë në vitet vijuese të studimit, konsiderohen të licencuara."*
13. Më 30 janar 2019, në seancën parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në lidhje me çështjen e mosnjohjes së diplomave, duke dhënë përgjigje në pyetje parlamentare, ish-ministri i Arsimit, z. Shyqiri Bytyqi, kishte theksuar se ministria përgatiste një udhëzim administrativ, i cili do ta rregullonte këtë çështje.

Rasti A.nr. 254/2021, [REDACTED]

14. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 29 prill 2021 e ka pranuar ankesën e z. [REDAKTUAR] parashtruar kundër [REDAKTUAR] dhe kundër Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASH), që ka të bëjë me mosverifikimin e diplomës.
15. Ankuesi më 19 shkurt 2019 i kishte përfunduar studimet në Kolegjin [REDAKTUAR], në programin studimor Master i Shkencave në Inxhinieri Softuerike. Pavarësisht faktit se Kolegji [REDAKTUAR] ka pasur akreditim në vitin akademik 2016/2017, kur është regjistruar ankuesi, atij nuk i njihet diploma në Gjermani.
16. Ankuesi jeton në Gjermani dhe autoritetet gjermane atje ia refuzuan njohjen dhe barasvlerësimin e nivelit të studimeve të përfunduara. Ky refuzim bazohet në mungesën e akreditimit të Kolegjit [REDAKTUAR] për shkak se programi i studimit nuk ka qenë i akredituar me rastin e diplomimit të gjeneratave sipas vitit akademik 2016/2017. Pavarësisht se ankuesi ka marrë një konfirmim zyrtar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim,⁴ sipas të cilit konfirmohej se programi studimor Inxhinieri Softuerike/MSc i Kolegjit [REDAKTUAR] është nënshtruar procesit të akreditimit dhe kërkesa e tyre për akreditim ishte miratuar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, përsëri problemi i tij nuk është zgjidhur pasi autoritetet gjermane për njohjen e barasvlerësimit kërkojnë akreditimin e programit më 19 shkurt 2019 dhe nuk e njohin diplomën për shkak se në kohën e diplomimit të ankuesit, Kolegjit [REDAKTUAR] i ishte refuzuar riakreditimi.⁵
17. Më 4 qershor 2021, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, nëpërmjet adresës elektronike, lidhur me këtë çështje, ka kërkuar informata nga sekretari i Kolegjit "Iliria", mirëpo nuk ka marrë përgjigje.
18. Kolegji [REDAKTUAR] në programin të cilin e ka përfunduar ankuesi është akredituar sipas Vendimit nr.558/14, i datës 4.7.2014, akreditimi ishte i vlefshëm për periudhën 1 tetor 2014 deri më 30 shtator 2017.
19. Më 7 nëntor 2016, Kolegji [REDAKTUAR] kishte parashtruar kërkesë për riakreditim, mirëpo më 1 mars 2017, sipas Vendimit Ref.129/17, kërkesa për riakreditim të programit Inxhinieri Softuerike, MSc (120 ECTS) ishte refuzuar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim. Po ashtu, më datën 31.10.2018 Kolegji [REDAKTUAR] kishte parashtruar kërkesë për riakreditim, mirëpo edhe kjo kërkesë e kolegjit ishte refuzuar sipas Vendimit Ref.:316/191D, i datës 22.2.2019.

Rasti A. nr. 534/2020. [REDAKTUAR]

20. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 21 shtator 2020 e kishte pranuar ankesën e z. [REDAKTUAR] parashtruar kundër Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH), që ka të bëjë me mosverifikimin e diplomës.

⁴ Konfirmim Ref.:165/120D, data 13.2.2020.

⁵ Kolegji [REDAKTUAR] ka parashtruar kërkesë për akreditim dhe riakreditim të programeve më datën 7.11.2016, AKA-ja më 1.3.2017 kishte nxjerrë Vendimin Ref.:129/17, sipas të cilit ishte refuzuar kërkesa për riakreditim të programit Inxhinieri Softuerike, MSc (120ECTS), po ashtu më datën 31.10.2018, Këshilli Shtetëror i Cilësisë më datën 22.2.2019 kishte nxjerrë Vendimin Ref.:316/191D, sipas të cilit ishte refuzuar kërkesa për riakreditim të programit të studimit Inxhinieri Softuerike, MSc, 120 ECTS.

21. Ankuesi i kishte regjistruar studimet në Kolegjin [REDAKTUAR] në vitin akademik 2014/2015, në programin studimor Menaxhment dhe Informatikë, studimet i kishte përfunduar në vitin 2017 dhe ende nuk mund ta verifikojë diplomën e fituar.
22. Më 13 maj 2019, Avokati i Popullit, përmes një letre drejtuar MASHTI-t, kishte kërkuar informata lidhur me rastin.
23. Më 23 maj 2019 kishte marrë përgjigjen me shkrim nga MASHTI, në të cilën thuhej: *"Kabineti i MASHT është gjerësisht i informuar për pamundësinë e një numri të madh të studentëve për të verifikuar diplomat në Divizionin NARIC në këtë institucion, për arsye se Institucionet përkatëse të Arsimit të Lartë nuk kanë dorëzuar dokumentacionin e duhur në afatin kohor të paraparë me legjislacionin në fuqi (në këtë rast librat amë) në Ministrinë e Arsimit."*
24. Ankuesi më 13 gusht 2020 i ishte drejtuar MASHTI-t me kërkesë për verifikimin e diplomës, mirëpo sipas pohimit të tij, ai nuk kishte marrë përgjigje me shkrim, por ishte njoftuar vetëm gojarisht se MASHTI se nuk mund ta bënte verifikimin e diplomës për shkak se Kolegji [REDAKTUAR] nuk e kishte dorëzuar librin amë.
25. Më 20 tetor 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, nëpërmjet adresës elektronike, kishte kërkuar informata nga Kolegji [REDAKTUAR] lidhur me rastin e mosverifikimit të diplomave të lëshuara nga kolegji. Në të njëjtën ditë, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit kishte marrë përgjigje, sipas së cilës ishte informuar se Kolegji [REDAKTUAR] më 12 nëntor 2019 kishte parashtruar padi në gjykatë për kompensimin e dëmit dhe kishte dërguar kopjen e skanuar të padisë së parashtruar.
26. Më 30 tetor 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit kishte takuar inspektorin e arsimit, nga i cili ishte njoftuar se më 8 tetor 2020 ishte formuar një komision i cili do të punonte vazhdimisht për zgjidhjen e këtij problemi, i cili ishte i përgjithshëm, si në arsimin privat, ashtu edhe në arsimin publik.
27. Më 25 janar 2021, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit është informuar nga inspektori i arsimit se ende nuk ishte ndërmarrë diçka konkrete se si do të veprohej lidhur me verifikimin e diplomave.

Rasti A.nr. 790/2018. [REDAKTUAR]

28. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 21 shtator 2020 e kishte pranuar ankesën e znj. [REDAKTUAR] parashtruar kundër Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), që ka të bëjë me mosverifikimin e diplomës.
29. Ankuesja kishte thënë se në vitin 2017 kishte përfunduar studimet në Kolegjin [REDAKTUAR] në nivelin master, në programin Menaxhment Shëndetësor, më 12 shtator 2018 kishte parashtruar kërkesë për verifikim, mirëpo që nuk kishte marrë përgjigje.
30. Më 15 maj 2019, Avokati i Popullit nëpërmjet një shkrese kishte kërkuar informata nga MASHTI lidhur me rastin.
31. Më 27 maj 2019, Avokati i Popullit kishte marrë përgjigjen nga z. Shyqiri Bytyqi, asokohe ministër i MASHT-it, përgjigjja e datës 23.5.2019, Referencë:107/11-B, nr. i Prot.:1980, në të cilën thuhej: *"Sa i përket rastit konkret, duhet të sqarohet se Divizioni*

i NARIC-ut, bënë verifikimin e diplomave mbi bazën e Udhëzimit Administrativ në fuqi. Mungesa e Librave Amë në Institucionin e MASHT, e bënë të pamundur verifikimin e dokumentacionit në fjalë.”

32. Sipas përgjigjes, Avokati i Popullit ishte njoftuar: *“Ministria ka ndërmarr disa veprime konkrete për zgjidhjen e kësaj problematike dhe si rrjedhojë ka formuar një komision në fillim të vitit 2018, përgjegjës për mbledhjen e gjithë dokumentacionit të Institucioneve të Arsimit të Lartë, të cilat nuk kanë respektuar afatet për dorëzimin e këtyre librave amë. Aktualisht është formuar një komision tjetër, i cili është duke rishikuar Udhëzimin Administrativ për verifikim të këtij dokumentacioni. . .”*
33. Më 2 tetor 2019, Avokati i Popullit nëpërmjet një shkrese kishte kërkuar informata nga ministri i MASHT-it dhe nga Departamenti për Arsimin e Lartë, lidhur me formimin e komisionit përgjegjës për mbledhjen e gjithë dokumentacionit të BAL-it, të cilët nuk i kishin respektuar afatet për dorëzimin e librave amë; si dhe të komisionit për rishikimin e udhëzimit administrativ për verifikimin e këtij dokumentacioni, mirëpo nuk ka marrë përgjigje.

Rasti A.nr.635/2020

34. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 30 tetor 2020 e kishte pranuar ankesën e z. [REDAKTUAR] parashtruar kundër Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), që ka të bëjë me mosverifikimin e diplomës.
35. Ankuesi kishte pohuar se ishte regjistruar në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, në Fakultetin Juridik, në vitin akademik 2011-2012, kurse në vitin akademik 2015-2016 ishte transferuar në Kolegjin [REDAKTUAR] dhe kishte diplomuar në vitin 2016, mirëpo nuk mund ta verifikonte diplomën.
36. Më 14 tetor 2020 i ishte drejtuar me kërkesë MASHT-it për verifikimin e diplomës, me qëllim të përdorimit të saj jashtë vendit, mirëpo nuk kishte marrë përgjigje sipas kërkesës së parashtruar.
37. Më 9 dhjetor 2020, Avokati i Popullit përmes një shkrese kishte kërkuar informata nga MASHT-i lidhur me rastin e ankuesit, mirëpo nuk kishte marrë përgjigje në afatin e përcaktuar.
38. Më 26 shkurt 2021, përmes një letre përsëritëse, Avokati i Popullit i është drejtuar asokohe ministrit të MASHT-it, z. Ramë Likaj, përmes së cilës ka kërkuar informata për rastin.
39. Më 1 mars 2021, Avokati i Popullit, përmes ministrit, ka marrë Përgjigjen Nr. 75/2021, nga z. Agim Bërdyna, ushtruese detyre i sekretarit të përgjithshëm, dhe nga znj. Kumrije Gagica, udhëheqëse në Qendrën Kombëtare për Njohje/Barasvlerë dhe Informim Akademik NARIC, ku thuhet: *“Oendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik ka lëshuar përgjigje se Kolegji [REDAKTUAR] për vitin akademik 2015/2016 nuk i ka dorëzuar Librin Amëz me studentët e regjistruar për këtë gjeneratë dhe për pasojë, dokumentet e dorëzuara nuk mund të verifikohen/validohen dhe nuk mund të vulozen nga MASHT. . . Duke qenë se ky problem derivon nga mosdorëzimi i librave amëz nga kolegjet, si në rastin e z. Racajt, MASHT ka formuar komisionin për trajtimin e problemeve që ndërlidhen me institucionet e arsimit të lartë (publike dhe private), ku trajtohet dhe problemi i*

mosdorëzimit të librave amëz nga Kolegjet.”

Rasti A.nr.605/2019, [REDACTED]

40. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 26 korrik 2019, përmes postës elektronike, e ka pranuar ankesën e z. [REDACTED] [REDACTED] parashtruar kundër Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (MASHT), për shkak të mosnoshtrifikimit të diplomës së nivelit Master të studimeve të përfunduara në Kolegjin universitar [REDACTED]
41. Sipas informatave dhe dokumentacionit të pranuar nga z. Shala, kuptohet se ai më 16 maj 2019 kishte parashtruar kërkesë në MASHT, gjegjësisht në NARIC (Qendra Kombëtare për Njohje të Diplomave), për verifikim të diplomës Master, me qëllim të vazhdimit të studimeve PhD jashtë vendit. Lidhur me këtë kërkesë, më 24 korrik 2019 NARIC nëpërmjet një shkrese, ndër të tjera, kishte njoftuar palën se aktualisht NARIC-u nuk mund të procedonte me verifikimin e diplomave, derisa të sqaroheshin çështje dhe procedura ligjore nga kolegji përkatës dhe MASHT-i, ku një komision i veçantë në nivel të MASHT-it do ta shqyrtonte dhe do ta zgjidhte këtë çështje.
42. Sipas shkresës me nr. 80/2019 të prezantuar nga pala, e lëshuar më datë 1.8.2019 nga Kolegji [REDACTED] për MASHT-in, ku kolegji pretendonte se ka bërë dorëzimin e librit amëz në MASHT dhe se tjetrin libër origjinal e posedonte në arkivin e kolegjit, por që pretendohet se librat janë humbur nga personat përgjegjës në MASHT.
43. Më 20 shtator 2019, përfaqësuesja e IAP-së, lidhur me rastin, ishte takuar me udhëheqësen e NARIC-ut, me qëllim të diskutimit të çështjes së ankuesit dhe veprimet që ishin ndërmarrë nga MASHT-i për adresim të çështjes. Në këtë takim përfaqësuesja e IAP-së ishte njoftuar se kjo kompetencë i ishte kaluar NARIC-ut në vitin 2018 dhe se nga instancat paraprake ishte kërkuar një raport për gjendjen faktike lidhur me procedurën e verifikimit. Po ashtu ajo kishte njoftuar se ishte formuar një komision nga ministri, por ende nuk kishte dalë me një vendim lidhur me çështjen, ndërsa kishte thënë se problemi qëndron në mosrespektimin e afateve kohore për dorëzimin e librave amëz nga kolegjet private dhe se kjo çështje ishte ngritur për diskutim edhe në Komisionin Parlamentar për Arsim dhe se po ashtu ishin iniciuar edhe hetime në prokurori.
44. Më 30 tetor 2019, përfaqësuesja e IAP-së përsëri i ishte drejtuar zyrtares përgjegjëse në NARIC për të mësuar nëse MASHT-i kishte arritur ta adresonte dhe të ofronte zgjidhje në këtë çështje. Lidhur me këtë kërkesë, IAP-ja ishte njoftuar se MASHT-i kishte filluar për disa kolegje me lëshimin e vërtetimeve të njohjes, mirëpo jo edhe për kolegjin ku ankuesi kishte përfunduar studimet.
45. Meqenëse çështja ende nuk ishte zgjidhur, më 28 shkurt 2020 dhe më 16 prill 2021, përfaqësuesja e IAP-së, përmes postës elektronike, i është drejtuar kabinetit të ministrit/es të MASHT-it me kërkesë për informim lidhur me ecurinë e rastit dhe po ashtu është kërkuar takim diskutimi me ministren e atëhershme të MASHT-it.
46. Më 21 prill 2021, përfaqësuesja e IAP-së ka marrë përgjigje nga udhëheqësja e NARIC-ut, në të cilën thuhet: “z. Shala, i ka përfunduar studimet në Kolegjin Evropian [REDACTED] ku edhe është pajisur me diplomë nga ky kolegji. Për qëllim të përdorimit të asaj diplome jashtë Kosovës, pala në fjalë është paraqitur në NARIC për

validimin/vulosjen e diplomës. Bazuar në raportin e pranuar nga Departamenti i Arsimit të Lartë, libri amëz për gjeneratën 2014/2015, mungon. Për të njëjtën gjë ekziston shënim (letër përcjellëse), e protokoluar në arkivë jashtë afateve ligjore të përcaktuara me UAMASHT: nr. 33/2014.

Mbi bazën e mungesës së librit amëz master të kësaj gjenerate dhe bazuar në legjislacionin në fuqi, NARIC e ka njoftuar z. [REDAKTUAR] se nuk mund të bëjë validimin/vulosjen e kësaj diplome. Lidhur me këtë çështje, Qendra NARIC e ka informuar palën me shkrim dhe po ashtu në takimet e realizuara në Qendër.

Për më tepër, ju njoftojmë se MASHT ka krijuar një komision të veçantë për zgjidhjen e problemeve në Arsim të Lartë, ku përfshihet edhe çështja e mungesave të librave amëz, por deri më tani komisioni ende nuk ka dalë me një vendim lidhur me këtë çështje.”

Rasti A.nr.276/2021, [REDAKTUAR]

47. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 6 maj 2021 e ka pranuar ankesën e z. [REDAKTUAR] parashtruar kundër Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (MASHT) dhe kundër Kolegjit [REDAKTUAR] për shkak të mosverifikimit të diplomës.
48. Ankuesi ka përfunduar studimet në Kolegjin [REDAKTUAR] në programin studimor Banka, Financa dhe Kontabilitet, niveli Bachelor, në vitin akademik 2016/2017, kurse më 28 maj 2019 i ishte drejtuar MASHTI-t me kërkesë për verifikimin e diplomës, por nuk kishte marrë përgjigje. Ankuesi kishte pohuar se programi studimor të cilin e ka përfunduar ishte i akredituar, mirëpo kolegji nuk i kishte dorëzuar librat amë në afatin ligjor.

Korniza ligjore e zbatueshme

Ekziston një varg instrumentesh ligjore që e rregullojnë këtë çështje, por pa u kufizuar te:

49. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Kushtetuta), në nenin 7 [Vlerat], paragrafi 1, përcakton: “Rendi kushtetues Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirisë të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.”
50. Kushtetuta, në nenin 21, paragrafi 1, përcakton: “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.” Kurse paragrafi 2 i këtij neni thotë: “Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.”
51. Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në nenin 4 (Parimi i ligjshmërisë), përcakton: “Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi si dhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. (...)”. Ndërsa sipas nenit 10, paragrafi 2, parashihet se: “Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën...”.

52. Ligji nr. 04/1-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, në nenin 1, përcakton: *"Qëllimi i Ligjit të arsimit të lartë është krijimi i bazës ligjore për rregullimin, funksionimin, financimin, sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në përputhje me standardet evropiane si dhe rolin e shtetit dhe shoqërisë në zhvillimin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës."*

Ndërsa sipas nenit 3 përcaktohet: *"1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:*

1.1. Akreditim - njohje formale se një institucion i arsimit të lartë dhe programet e tij i plotësojnë standardet ndërkombëtarisht të pranuar të cilësisë dhe se kualifikimet e tij u japin bartësve të tyre, në pajtim me ligjin në fuqi, një numër të drejtash, siç janë mundësia për qasje në një nivel të mëtejshëm arsimor, profesione specifike dhe për të përdorur një titull.

1.9. NARIC - Qendra shtetërore për njohje dhe informim akademik (për Kosovë ose për ndonjë vend tjetër). - NARIC Kosova, ndihmon në promovimin e lëvizshmërisë së studentëve, mësimdhënësve dhe hulumtuesve, duke ofruar këshilla dhe informacione kompetente në lidhje me njohjen akademike të diplomave dhe të periudhës së studimeve, të ndërmarra në shtete të tjera. Vendimet mbi njohjen dhe barasvlerën merren nga Këshilli shtetëror për njohje në pajtim me standardet evropiane.

1.12. Program - program studimi që shpie në një kualifikim ose diplomë, që jepet nga një bartës i arsimit të lartë.

1.16. Organ akreditues i njohur - Agjencia Kosovare e Akreditimit apo ndonjë organ i ngjashëm i tillë, i cili në Zonën evropiane të arsimit të lartë, është aktualisht i anëtarësuar në rrjetin evropian për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë /ENQA/, ose (në Shtetet e Bashkuara), është një organ akreditues i cili është i njohur nga Këshilli i akreditimit për arsimin e lartë /CHEA/ apo nga Departamenti i Arsimit i Shteteve të Bashkuara /USDE/ apo nga të dyja, ose (në cilindo juridiksion tjetër) është pranuar nga Ministria në baza të ndërsjella si një organ i themeluar në mënyrë të duhur shtetëror a rajonal i akreditimit, që njihet dhe është i autorizuar nga ministria relevante në kuadër të atij juridiksioni."

Sipas nenit 5 përcaktohet:

"1. Në arsimin e lartë që ofrohet nga bartësit e licencuar të arsimit të lartë në Kosovë do të kenë qasje të gjithë personat brenda apo jashtë territorit të Kosovës, pa asnjë lloj diskriminimi.

4. Një kualifikim, diplomë ose përvojë shtetërore a ndërkombëtare mund të pranohet si e barasvlerëshme me shkallën Baçellor, të cekur në nën-paragrafin 2.1, paragrafi 2, i nenit 4 të këtij ligji nga bartësi i arsimit të lartë, i akredituar në Kosovë sipas këshillës së NARIC Kosova. Në rastin e paraqitjes për vlerësim të një certifikate të marrë nga një institucion i arsimit të lartë, duhet të jetë i akredituar nga një organ akreditues i njohur, siç është përkufizuar në nenin 3 të këtij ligji."

Ndërsa paragrafi 7, i këtij neni përcakton se: "Arsimi i lartë mund të ofrohet nga çdo bartës i licencuar i arsimit të lartë, pa kufizim për sa i përket kohëzgjatjes apo strukturës së vitit shkollor, me kusht që të mund të ia dëshmojë në mënyrë të kënaqshme një organi akreditues të njohur se diplomat e tij plotësojnë standardet e pritshme për diploma të tilla brenda Zonës evropiane të arsimit të lartë."

53. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Ministrisë në ofrimin e arsimit të lartë përcaktohen sipas nenit 6:

"1. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me dokumentet plotësuese të nxjerra mbi bazën e tij dhe të atyre të nxjerra në bazë të nenit 14 të Ligjit për arsim në komunat e Republikës së Kosovës (03-L-068, të majit 2008), Ministria është përgjegjëse për:

1.1. planifikimin e zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë, në konsultim me Bartësit e akredituar të arsimit të lartë;

1.6. promovimin e lëvizjes së studentëve dhe të personelit brenda Zonës evropiane dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë si dhe inkurajimin për përdorimin e gjuhës angleze për mësim krahas gjuhëve zyrtare. Vendosjen e rregullave lidhur me njohjen akademike dhe profesionale, në përputhje me standardet evropiane, qoftë përmes NARIC Kosova brenda Ministrisë, ose përmes Agjencisë Kosovare për Akreditim dhe informimi i publikut për statusin e kualifikimeve të huaja përmes ENIC Rrjetit evropian të qendrave për informim;

1.7. promovimin e mundësive të barabarta në qasjen dhe pranimin në arsimin e lartë, në zhvillimin dhe trajnimin e personelit, në mundësitë për të mësuar gjatë gjithë jetës dhe në të gjitha aspektet e tjera të arsimit të lartë."

54. Neni 2 i Ligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës rregullon mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të aplikueshëm në të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime edukative, arsimore

Neni 2: *"Ky ligj trajton mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të aplikueshëm në të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime edukative, arsimore dhe aftësuese."*

Sipas nenit 5: *"1. Inspektorati i Arsimit kryen këto funksione:*

1.1. Funksionin vlerësues – vlerëson cilësinë e shërbimit të institucioneve arsimore.

1.2. Funksionin kontrollues – kontrollon pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve arsimore me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi."

Ndërsa detyrat e inspektorit administrativ përcaktohen sipas nenit 10:

"1. Inspektori administrativ është përgjegjës për të mbikëqyrë dhe vlerësuar nëse institucionet arsimore zbatojnë legjislacionin në fuqi."

Sipas nenit 13, Vendimet e inspektorit të arsimit, në paragrafin 1, pika 1.9, përcaktohen veprimet që mund t'i ndërmarrë inspektorati: *"Të ndërpres punën e institucioneve arsimore që janë të pa licencuara, institucioneve që nuk i plotësojnë standardet dhe kriteret e parapara me ligj."*

Paragrafi 2. Inspektori i arsimit ndërpret dhe ndalon:

"2.1. punën e personit juridik dhe fizik që ushtron veprimtari arsimore (edukative, arsimore dhe aftësuese) pa licencë pune nga MASHT.

2.2. punën e institucionit arsimor, personit juridik dhe fizik që ushtron veprimtari arsimore në kundërshtim me legjislacionin në fuqi."

Sipas nenit 25, parashihet edhe mbyllja e institucionit arsimor: *"Inspektorati i arsimit e mbyllë institucionin arsimor i cili vepron në kundërshtim me vendimin e akreditimit dhe licencën që e posedon."*

55. Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, sipas nenit 5, paragrafi 1, përcaktohet: *"Akreditimi është njohje formale se një institucion i arsimit të lartë dhe/apo programet e tij të studimit i plotësojnë standardet ndërkombëtarisht të pranuarra të cilësisë."* Ndërsa sipas paragrafit 3 përcaktohet: *"Akreditimi në fushën e arsimit të lartë e siguron shoqërinë kosovare se cilësia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimeve shkencore janë të krahasueshme ndërkombëtarisht."* Nenit 8, paragrafi 1, përcakton: *"Secili institucion i cili pretendon të ofroj arsim të lartë në Kosovë, i nënshtrohet akreditimit fillestar."*
56. Udhëzimi Administrativ MASHT: Nr.33/2014 Libri amëz i studentëve të institucioneve të arsimit të lartë është nxjerrë me qëllim që të rregullojë mbajtjen dhe ruajtjen e të gjitha të dhënave relevante për studentët e regjistruar në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Sipas nenit 3, paragrafi 1, përcaktohet: *"Libri amëz duhet të plotësohet në fillim të secilit vit akademik (më së voni me datë 15 tetor për studime themelore dhe deri me 15 nëntor për studime master e doktoraturë."* Ndërsa sipas paragrafit 3 parashihet: *"Data e fundit për dorëzimin në MASHT i kopjes fizike të origjinalit të librave amëz është deri me datë 20 tetor për studime themelore dhe 20 nëntor për studime master e doktoraturë, pas kësaj date ato nuk do të pranohen."*

Analiza e çështjes

57. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se Kushtetuta, si akti më i lartë juridik i një vendi, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta në nenin 21 shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve për t'i respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, prandaj ky parim është domosdoshmëri e kohës dhe duhet të respektohet nga të gjithë.
58. Të drejtën e arsimit Kushtetuta e garanton si të drejtë të përgjithshme të njeriut që e gëzon çdo person (neni 47, paragrafi 1), po ashtu Kushtetuta i garanton çdo personi mundësi të barabarta të shkollimit në bazë të nevojave dhe të aftësive individuale, që do të thotë se në realizimin e së drejtës së arsimit nuk lejohet të ketë kurrfarë diskriminimi (neni 47, paragrafi 2). Këtë dispozitë kushtetuese e përmbajnë më tutje ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, të cilat parashohin që në zbatimin e të drejtave dhe të obligimeve të veta, institucionet publike duhet t'i respektojnë të drejtat e njeriut, duke u mundësuar arsimin në pajtim me dispozitat ligjore dhe me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
59. Në kuptim të dispozitës së nenit 2 të Protokollit Nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Avokati i Popullit rikujton se e drejta për arsimim u ofron individëve të drejtën për të pasur qasje efektive në institucionet arsimore që ekzistojnë si dhe përcakton se shtetet nuk mund të mohojnë të drejtën për arsimim në institucionet arsimore.
60. Sipas dispozitave ligjore, akreditim do të thotë: *"Njohje formale se një institucion i arsimit të lartë dhe programet e tij i plotësojnë standardet ndërkombëtarisht të pranuarra të cilësisë dhe se kualifikimet e tij u japin bartësve të tyre, në pajtim me ligjin në fuqi, një"*

numër të drejtash, siç janë mundësia për qasje në një nivel të mëtejshëm arsimor, profesione specifike dhe për të përdorur një titull.” Organ akreditues është Agjencia Kosovare e Akreditimit. Po ashtu, MASHTI ka kompetenca dhe përgjegjësi: “Vendosjen e rregullave lidhur me njohjen akademike dhe profesionale, në përputhje me standardet evropiane, qoftë përmes NARIC Kosova brenda Ministrisë, ose përmes Agjencisë Kosovare për Akreditim dhe informimi i publikut për statusin e kualifikimeve të huaja përmes ENIC Rrjetit evropian të qendrave për informim.”

61. Duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lart, BAL-i ka obligim t’i respektojë këto dispozita, ndërsa MASHTI e ka për obligim ta mbikëqyrë zbatimin e tyre, asnjë bartës i arsimit të lartë nuk mund të funksionojë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe pa siguruar cilësinë e arsimit, po ashtu nuk duhet lejuar funksionimi i asnjë bartësi të arsimit të lartë publik apo privat nëse në afatin e caktuar ligjor nuk i dorëzon librat amë.
62. Në rastet konkrete, pavarësisht mosrespektimit të afateve ligjore apo veprimi në kundërshtim me dispozitat ligjore, bartësit e arsimit të lartë janë lejuar të funksionojnë dhe si pasojë studentët, edhe pse pa fajin e tyre, tani i vuajnë pasojat për shkak të mosnjohjes dhe mosverifikimit të diplomave të tyre.
63. Sa i përket çështjes së njohjes dhe verifikimit të diplomave, pavarësisht faktit se MASHTI, disa herë në të kaluarën, përmes vendimeve të ministrave, udhëzimeve administrative dhe anekseve plotësuese, është angazhuar të gjejë një zgjidhje lidhur me çështjen, zgjidhja është bërë vetëm për disa kolegje dhe vetëm në disa periudha kohore. Prandaj, duke u bazuar në ankesat e pranuar në Institucionin e Avokatit të Popullit, vërehet se problemi i mosnjohjes/mosverifikimit të diplomave të lëshuara nga universitetet dhe kolegjet në Kosovë ende është i pranishëm.
64. Lidhur me mosnjohjen e diplomave të bartësve të arsimit të lartë privat, por edhe publik, ministrja aktuale kishte deklaruar: “[...] është e vërtetë se në sistemin e arsimit ka pasur lëshime më shumë se dy dekada dhe për fat të keq kemi trashëguar probleme të jashtëzakonshme. gjykata i ka trajtuar disa raste dhe pastaj MASHTI është obliguar t’i zbatoj ato vendime, me pranimin e detyrës jam përballur me pyetje dhe i di shqetësimet dhe ankesat e studentëve, në të kaluarën kanë punuar dy komisione lidhur me njohjen e diplomave, por nuk është që kanë sjellë të dhëna të sakta lidhur me çështjen e librave amë dhe të çështjes së regjistrimit në SMIAL⁶ të cilat na kanë sjellë probleme lidhur me tituj dhe diploma. [...] zgjidhjen e vetme që e kam parë është që të krijohet një komision të pavarur nga profesionistë të cilët do të japin rekomandime se si do të zgjidhet kjo çështje.”⁷
65. Sa i përket Rastit nr.24/2018 [REDAKTUAR], kundër MASHTI-t (shih nga paragrafi 3 deri 13 të këtij raporti), pavarësisht miratimit të numrit të studentëve në universitet, edhe përkundër vendimit të MASHTI-t për njohjen e diplomave të tyre, ankuesit ende përballen me problemin dhe çështja e tyre ende nuk ka marrë ndonjë epilog, për shkak se programet studimore të cilat i kanë përfunduar nuk kanë pasur akreditim.
66. Në lidhje me Rastin A.nr.254/2021 [REDAKTUAR] - MASHTI (shih nga paragrafi 14 deri 19 të këtij raporti), ankuesi është regjistruar në vitin akademik 2016/2017, kur kolegji ka pasur vetëm edhe një vit akreditim, ndërsa ka përfunduar

⁶ Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë.

⁷ <https://www.youtube.com/watch?v=49UL5VJqFwM>, Deklarata në ATV- Emissioni Context, nga min. 1.05.00.

studimet master në vitin 2019, pastaj në vitin 2017 kërkesa e kolegjit për riakreditim i ishte refuzuar me arsyetimin se Kolegji [REDAKTUAR] kishte mungesë të stafit akademik me dokumentacion të rregullt për këtë program.

Në rastin konkret, pavarësisht refuzimit të riakreditimit, ankuesi kishte vijuar studimet dhe të njëjtat i kishte përfunduar në Kolegjin [REDAKTUAR].

Sipas nenit 9, paragrafi 4, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, përcaktohet: *“Me rastin e paraqitjes së aplikacionit për ri/akreditim institucional, çdo institucion privat i arsimit të lartë obligohet që të sjellë në AKA marrëveshje të bashkëpunimit me të paktën dy bartës të tjerë të akredituar të arsimit të lartë që sigurojnë se studentët mund të transferohen në programe të ngjashme tek njëri nga këta bartës të akredituar, në rast të falimentimit apo tërheqjes së ri/akreditimit institucional.”*

67. Prandaj, duke u bazuar në këtë, nëse një kolegji fillimisht është akredituar, ndërsa riakreditimi i është refuzuar, do të duhej të zbatohet kjo dispozitë dhe studenti të transferohej tek një bartës i akredituar, në rastin konkret, edhe përkundër refuzimit të riakreditimit për shkak të konstatimit se kolegjit i mungonte stafi akademik me dokumentacion të rregullt për këtë program, ankuesi kishte vijuar studimet dhe të njëjtat i kishte përfunduar.
68. Sa i përket rasteve nga paragrafi 20 deri te paragrafi 48 të këtij raporti, studentët ballafaqohen me mosnjohjen/mosverifikimin e diplomave për shkak se kolegjet në të cilat kishin përfunduar studimet nuk i kishin dorëzuar apo nuk i kishin respektuar afatet ligjore për dorëzimin e librave amë, në rastet konkrete, studentët nuk kishin pasur asnjë obligim lidhur me dorëzimin e librave amë dhe as që kishin mundur të ndikonin në këtë çështje në kolegjet ku kishin studiuar.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

69. Avokati i Popullit vëren se sipas Ligjit nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, Inspektorati i Arsimit e ka obligim ligjor ta mbikëqyrë dhe ta vlerësojë zbatimin e dispozitave ligjore, edhe përkundër dispozitës e cila e përcakton qartë se Inspektori i Arsimit e ndërpret dhe ndalon *“punën e institucionit arsimor, personit juridik dhe fizik që ushtron veprimtari arsimorë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.”*, si dhe *“Inspektorati i arsimit e mbyllë institucionin arsimor i cili vepron në kundërshtim me vendimin e akreditimit dhe licencën që e posedon”*, si rezultat i mosveprimit ato kanë mbetur të pazbatuara. Prandaj Inspektorati i Arsimit ka dështuar t'i ndërmerre veprimet e parapara sipas Ligjit nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.04/2019.⁸ MASHTI nuk duhet të lejojë funksionimin e kolegjeve të cilat nuk janë të akredituara.

⁸ Më 19.7.2018, Avokati i Popullit, përmes Letër Rekomandimit Ex Officio A.nr.736/2017, i ka rekomanduar MASHT-it: *“Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore, të krijohet parakushtet e nevojshme që Inspektorati i Arsimit të mund të zbatojnë sanksionet administrative. . .”* Po ashtu, Avokati i Popullit, edhe sipas Raportit me Rekomandime Ex officio A.nr.720/2019, i ka rekomanduar MASHTI-it: *“Të sigurojë që Inspektorati i Arsimit, si organ ekzekutiv qendror, t'i ndërmarrë të gjitha veprimet për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të aplikueshëm në të gjitha institucionet edukativo-arsimore.”*

70. Avokati i Popullit vëren se edhe përkundër formimit të komisionit për këtë çështje, që nga fillimi i vitit 2018 e deri më tani nuk është zgjidhur çështja e njohjes/verifikimit të diplomave.
71. Avokati i Popullit vëren se sipas Aneksit I të Udhëzimit Administrativ nr.3/2010, i datës 16.4.2010, të gjitha diplomat e studimeve të zhvilluara para vitit akademik 2007/2008, të cilat kanë filluar pa u pajisur me licencë, konsiderohen të licencuara. Po ashtu, sipas Informatës Nr.192/01B të MASHT-it, e datës 13.7.2012, Universitetit Publik “Ukshin Hoti” në vitin akademik 2012/2013 i ishte miratuar numri i studentëve sipas programeve studimore, të cilat i kanë përfunduar ankuesit, si dhe sipas Vendimit Nr.061/01B, i datës 18.4.2014 ishte vendosur për njohjen e diplomave për vitin akademik 2011/2012 dhe 2012/2013. Duke u bazuar në këto fakte, Avokati i Popullit konstaton se MASHTI që nga viti 2010 ishte në dijeni se disa bartës të arsimit të lartë, edhe përkundër mungesës së akreditimit dhe licencimit, janë duke funksionuar, mirëpo pavarësisht kësaj, nuk u ndërmoren veprimet e duhura për t'i ndërprerë këto praktika, por në kundërshtim me dispozitat ligjore miratuan numrin e studentëve në Universitetin Publik “Ukshin Hoti”, pastaj ministri i MASHTI-t kishte nxjerrë edhe vendim për njohjen e diplomave (shih paragrafin 10). Prandaj këto veprime kishin krijuar pritshmëri legjitime te kandidatët e diplomuar në këtë universitet.
72. Avokati i Popullit konstaton se zgjidhja përmes një Programi për Avancimin e Kualifikimit vetëm për tri kolegje është e pjesshme dhe vetëm për disa periudha kohore⁹, prandaj zgjidhja e tillë është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë të kandidatëve. Edhe pse kjo praktikë e paanshme në dukje, i ka vënë në pozitë të pabarabartë ankuesit në krahasim me të diplomuarit në këto tri kolegje.
73. Nëse në njërën anë, pavarësisht mosakreditimit dhe mungesës së licencës, disa të diplomuarve në disa kolegje dhe në disa periudha kohore është vendosur t'u njihen/verifikohen diplomat, ndërsa në anën tjetër, ankuesve nuk u njihet kjo e drejtë dhe ende përballen me pasojat e mosnjohjes/mosverifikimit të diplomave, atëherë nëse i krahasojmë këto dy kategori, të cilat në kushte të njëjta kishin përfunduar studimet në programe të pa akredituara apo të pa licencuara, atëherë, në rrethana të tilla mund të flasim për një trajtim pabarabartë.
74. Duke qenë se akreditimi është proces që garanton se një institucion i arsimit të lartë dhe programet e tij i plotësojnë standardet ndërkombëtare të pranura të cilësisë dhe se kualifikimet e lëshuara nga BAL-i u japin bartësve të tyre një numër të drejtash, siç është mundësia për qasje në një nivel të mëtejshëm arsimor, Avokati i Popullit konstaton se BAL-i kanë lëshuar diploma në kundërshtim me procedurat e akreditimit dhe licencimit.
75. Avokati i Popullit konstaton se dorëzimi i librave amë në afatin e përcaktuar ligjor është obligim i BAL-it, moszbatimi i tyre është përgjegjësi e secilit BAL, në rastet konkrete, edhe mbajtja dhe ruajtja e të dhënave relevante për studentët e regjistruar në institucionet e arsimit të lartë është përgjegjësi e institucioneve e jo e studentëve, ndërsa mbikëqyrja e

⁹ Vendimi Ref.nr.230/01B është nxjerrë më 4 gusht 2015, në Programin për Avancimin e Kualifikimit janë përfshirë të diplomuarit në Fakultetin e Edukimit në BPrAL Kolegji Universum - Dega në Ferizaj, në Fakultetin e Edukimit në BPrAL Kolegji Gjilani dhe në Fakultetin e Edukimit në BPrAL Kolegji Vizioni Evropian, të cilët janë regjistruar në vitet akademike 2006/2007 dhe 2007/2008.

zbatimit të dispozitave ligjore është përgjegjësi e MASHTI-t.

76. Po ashtu, Avokati i Popullit vëren se edhe promovimi i lëvizjes së studentëve i të personelit brenda zonës evropiane dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë është obligim ligjor i MASHTI-t. Prandaj, duke pasur parasysh faktin se të diplomuarit kanë probleme lidhur me njohjen/verifikimin e diplomave, atyre u pamundësohet edhe lëvizja brenda zonës evropiane dhe ndërkombëtare për t'i vijuar studimet dhe si pasojë u kufizohet edhe qasja në arsim.

Avokati i Popullit, duke u bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.” Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: “(...) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla (...)” Prandaj Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit:

1. *Të angazhohet që komisionet e formuara nga MASHTI t’i përfundojnë detyrat e dhëna në një afat të arsyeshëm kohor dhe çështja e njohjes/verifikimit të diplomave të marrë epilog, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe në pajtim me standardet evropiane.*
2. *Të sigurojë që Inspektorati i Arsimit, si organ ekzekutiv qendror, t’i ndër marrë të gjitha veprimet efektive për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të aplikueshëm nga të gjithë Bartësit e Arsimit të Lartë, deri në ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë, në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerri lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit